

STATUTI

I SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "S3 FINANCE" SH.P.K

KREU 1

Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia

THEMELIMI I SHOQËRISË

NENI 1

Duke u bazuar në ligjin nr 9901 date 14.04.2008 "Për shoqërite tregtare" dhe ne ligjin nr 131 i dates 26.11.2015 "Per Qendrën Kombëtare të Biznesit ", ne përkatësisht: Saimir Shala i biri i Jakupit dhe i Vjollces i datëlindjes 17.05.1990, identifikuar nga Nr. Personal J005171200 dhe Erion Shala i biri i Jakupit i datëlindjes 02.11.1992, identifikuar nga Nr. Personal J21102084W nën vullnetin tonë të lirë sot me datë 05.03.2020 nënshkruajme miratimin e statutit të shoqërisë **"S3 FINANCE" sh.p.k .**

FORMA E SHOQËRISË

NENI 2

Kjo Shoqëri do jetë "Shoqëri Tregtare" e formës "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k) **"S3 FINANCE" sh.p.k.** Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare .

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 3

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do te jetë pa afat duke filluar nga data 05.03.2020.


EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të quhet **"S3 FINANCE" sh.p.k** dhe vula e saj ka formën rrethore në të të cilën do shkruhet **"S3 FINANCE" sh.p.k.**

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike te kësaj shoqërie është :



Konsulence financiare, shërbime kontabiliteti, konsulence marketingu, konsulence dhe këshillime ligjore e juridike, hartim plan biznese, organizimi i trajnimeve dhe konsulence për menaxhimin financiar.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 5

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën Lagjja Tom Kola, Rruga Marin Biçikemi, Godine 4 kateshe, kati I-re, nr pasurie 4/253/-N.

KREU 2

Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërisë, Administratori, Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar është në vlerën 150 000 lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë). Ortaket themelues i shoqërisë janë Z. Saimir Shala i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 75 000 lekë (shtatëdhjetë e pesë mijë lekë) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe Z. Erion Shala i cili zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 75 000 lekë (shtatëdhjetë e pesë mijë lekë) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjetër në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.


NENI 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të kodit civil dhe atij tregtar.

Asambleja e ortakëve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të jenë të vërtetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë asambleja e përgjithshme duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

NENI 8



Kapitali themeltar i shoqërisë mund te rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet ne regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme shoqëria ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa personave fizikë jashtë shoqërisë ose personave juridik, vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit noterial te tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKB-së.

NENI 9

Kapitali nuk mund te jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet para kërkesës së drejtuar në QKB për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht .

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 10

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dha ajo ushtron te gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare: i nje asamblesë së ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme mund t'ja delegojë kompetencat një ose shumë administratoreve caktuar prej saj dhe nje personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërië vetëm mbi bazën e prokurës.


NENI 11

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit

NENI 12



Kjo shoqëri administrohet nga administratori Z. Saimir Shala i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, nga data 05.03.2020 deri me datë 05.03.2025, me të drejtë ndryshimi me konsesusin e ortakëve.

EKSPERTI KONTABËL

NENI 13

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga asambleja e përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë akt gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ana e asamblesë..

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit me shkrim, nxjerrjen e rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

NENI 14

Nxjerrja e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

NENI 15

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.



NENI 16

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyrjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë sado qofshin ato.

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimet të mëtejshëm të veprimtarisë së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për falimentimin"



Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatore dhe duke shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij dhe emertesën "Shoqëri në likuidim e sipër".

NENI 18


Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtrojnë ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrimit në QKB.

NENI 19

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Përgjithshme si dhe legjislacioni në fuqi.

ORTAKET E SHOQËRISË

Saimir Shala



Erion Shala

